



**Drejtuar:** Operatorin Ekonomik “INFRATECH” shpk

**Adresa:** Rruga Besim Imami, pallati 12-katesh, kati i 2-te, nr.13, Tiranë

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit:** *“Mbikqyrja e punimeve e katër objekteve në infrastrukturë arsimore dhe shërbime publike në qytetin e Tiranës për vitin 2019”, të ndarë në lote si më poshtë vijon, Loti i dytë: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rikonstruksion i Biblotekës së Qytetit, Nj.A 6”*

**Nr. References:** 24740-05-30-2019

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është: *Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rikonstruksion i Biblotekës së Qytetit, Nj.A 6”*, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

**Fondi limit, Loti i dytë:** 49,852.5 (dyzet e nëntë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy pike pesë) lekë pa tvsh.

**Burimi i financimit:** Vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës VKB Nr. 159, datë 21.12.2018, për “Miratimin e Programit buxhetor afatmesëm 2019 - 2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr.47878/1 datë 28.12.2018”, me objekt: *“Mbikqyrja e punimeve e katër objekteve në infrastrukturë arsimore dhe shërbime publike në qytetin e Tiranës për vitin 2019”, të ndarë në lote si më poshtë vijon, Loti i dytë: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rikonstruksion i Biblotekës së Qytetit, NjA 6”.*

**Kohëzgjatja e kontratës:** Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve, 7 ( shtatë ) javë kalendarike.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 10.06.2019, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr.22 dt. 03.06.2019**

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik "Infratech" shpk, me nr. NIPT K91628001D**

Vlera e ofertës = **40,176.67** (dyzet mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.

**2. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik "M.A.K Studio" shpk me nr. NIPTI L01422017O**

Vlera e ofertës = **40,728** (dyzet mijë e shtatëqind e njëzet e tetë) lekë.

**3. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik, "Novatech Studio" shpk, me nr. NIPTI L01717030C**

Vlera e ofertës = **40,176.6** (dyzet mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë) lekë

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

**1.Operatori Ekonomik, "Novatech Studio" shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Operatori ekonomik "Novatech Studio" shpk, nuk ka respektuar VKM Nr. 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim", cituar ne paragrafin e fundit te Kriereve te Vecanta te Kualifikimit te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor."Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Kjo Bazuar ne njoftimin e bere me Nr. 5585 date 25.07.2017 te Agjensise se Prokurimit Publik "Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te Specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 354 date 11.05.2016 "Per Miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim", si dhe njoftimit Nr. Prot 13565 date 06.11.2017 te Agjensise se Prokurimit Publik "Terheqje Vemendje", ku kerkohet detyrimisht zbatimi i akteve ligjore, nenligjore dhe VKM 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim".Sa me siper u Konstatua se Vlera e ofertes ekonomike te ofertuar nga Operatori Ekonomik nuk eshte ne perputhje me VKM 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim" pasi eshte me e ulet se vlera minimale e perlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor, per kete procedure.

Bazuar ne Rekomandimin e APP-se Nr. 5585 date 25.07.2017 "Mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne VKM Nr.354 date 11.05.2016 "Per Miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim, pika 2, Shprehimisht thuhet se:"Ne rrethana te jashtezakonshme dhe nese dokumentohet me shkrim, tarifat mund te jene me ulta se sa normat minimale, te specifikuara nga ky manual"

Ne rastin kur operatori ekonomik nuk ka dokumentuar rrethanen e jashtezakonshme, Autoriteti Kontraktor gjate vleresimit te ofertes duhet ti referohet vleres minimale te perlllogaritur per kete procedure prokurimi ne baze te parashikimit te VKM Nr. 354 date 11.05.2017 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim"Ne rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nese ndodhet ne rrethana te jashtezakonshme per proceduren e prokurimit me objekt: Loti i Dytë: "Mbikqyrja e punimeve për objektin: **“Rikonstruksion i Bibliotekës së Qytetit, Nj.A 6”**”.

Per sa me siper theksojme se eshte detyre e operatorit ekonomik te garantoje qe oferta e paraqitur te jete ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi, si rrjedhoje konkudojme se dokumentacioni i paraqitur nga Operatori ekonomik "Novatech Studio" shpk nuk ka permbushur Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Respektim te VKM Nr.354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim".

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

#### **Janë shpallur si ofertues të suksesshëm:**

- **Operatori ekonomik "Infratech" shpk, kualifikohet në vend të parë.**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **40,176.67** (dyzet mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë. Çmimi total i ofertës me tvsh = **48,212** (dyzet e tetë mijë e dyqind e dymbëdhjetë) lekë.

**Afati kohor për realizimin e shërbimit është nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërrmarjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve 7 (shtatë) javë kalendarike.**

- **Operatori ekonomik "M.A.K Studio" shpk, kualifikohet në vend të dytë.**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **40,728** (dyzet mijë e shtatëqind e njëzet e tetë) lekë. Çmimi total i ofertës me tvsh = **48,874** (dyzet e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

**Afati kohor për realizimin e shërbimit është nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërrmarjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve 7 (shtatë) javë kalendarike.**

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 14.06.2019

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik Infratech” shpk, me nr. NIPTI K91628001D**, me adresë: Rruga Besim Imami, pallati 12-katesh, kati i 2-te, nr.13, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme **40,176.67** (dyzet mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitörja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) , siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.